



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Bazuar ne nenin 11 paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës se Kosovës ,Nenit 15,16 dhe 29 paragrafi 1; i Rregullores Nr. 02/2010 për procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil , neni 7 paragrafi 2 i UA nr.02/2015 në Shëndetësi , dhe nenit 14 të Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare – Prishtinë, Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale shpall këtë:

K O N K U R S
PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

I. POZITA: Drejtor i Qendrës Kryesore te Mjekësisë Familjare Prishtinë

KOEFICIENTI : 12-H-

LLOJI I POZITËS : Me afat të caktuar (mandat 4 vjeçar)

KATEGORIA FUNKSIONALE: Nivel drejtues

ORARI I PUNËS: 40 orë në javë

PËRGJEGJËSI MBIKËQYRËSE: Po

MBIKËQYRJA: Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

DETYRA KRYESORE TË PUNËS:

- Siguron Ligjshmërinë dhe punën profesionale në QKMF, e cila duhet të udhëhiqet në pajtim me dispozitat e Statutit të QKMF-së;
- Është përgjegjës për përkujdesjen efektive të Shëndetësisë parësore për të gjithë banorët e Komunës së Prishtinës;
- Në pajtim me Politikën shëndetësore ,Ligjin për Shëndetësi në Kosovë dhe Strategjinë e Kujdesit parësorë shëndetësorë i propozon Drejtorit të Drejtoriatit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale planin e punës dhe buxhetin e QKMF-së,për vitin vijues;
- Kujdeset për zbatimin e planit të burimeve njerëzore;
- Kujdeset për udhëheqjen e përditshme të procesit të punës;
- Kujdeset për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të personelit të QKMF-së;
- Kontribuon në zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësorë të QKMF-së;
- Ushtron të drejta dhe autorizime dhe mban përgjegjësi të tjera në përputhje me dispozitat ligjore dhe aktet tjera që kanë të bëjnë me implementimin e Mjekësisë Familjare.

KUSHTET:

- Aftësi të plotë për përmbushjen e detyrave të vendit të punës, me orar të plotë pa kufizime dhe pengesa ligjore;
- Përgatitje universitare: Fakulteti i Mjekësisë- specialist i mjekësisë familjare,
- Aftësi të mira analitike dhe komunikuese;
- Të ketë së paku 5 vite përvojë pune në shëndetësi;
- Të ketë së paku një vit përvojë pune nga fusha e menaxhimit dhe zbatimit të mjekësisë familjare;
- Njohja e gjuhës angleze e dëshirueshme;
- Njohuri të punës me kompjuter;
- Aftësi të tjera që shërbejnë për kryerjen e detyrave të punës dhe raport kolegial në marrëdhënie të punës.

DOKUMENTET E NEVOJSHME PER APLIKIM;

- Dokumentet personale
- Diplomë universitare
- Licencë pune i lëshuar nga organi kompetent
- Dëshmi për përvojë pune në shëndetësi
- Vërtetim mbi gjendjen shëndetësore i lëshuar nga institucioni publik shëndetësore

Data e shpalljes së Konkursit: 02.12.2016 deri më 19.12.2016

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në objektin e vjetër të Komunës.

Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe dokumentet e bashkangjitura aplikacionit duhet të jenë kopje dhe nuk kthehen.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet e Kosovës”.

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes për pozitat e cekura më lart.

KPSHC (Komisioni përzgjedhës i shërbimit civil) duke u bazuar në nenin 25 paragrafi 1 të Rregullores NR. 02/2010 për procedurat e rekrutimit të shërbimit civil, mund të verifikoi me institucionet përkatëse vërtetësinë e të dhënave të sigurta nga kandidatët.

Për çdo informatë plotësuese mund të kontaktoni me Sektorin e Burimeve Njerëzore, zyra nr. 40, në këtë nr. të telefonit 038/230-900 lokali 10-70.

